

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-161/14

Prishtinë, 3 Shkurt 2016

Në çështjen juridike të:

A.V. i

Gërlicë e përme,

Kaçanik

Pala ankuese

Kundër

C.S.

Pasjak, Krushevac

Republika e Serbisë

Pala përgjegjëse në ankesë/parashtruesi e kërkesës

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Beshir Islami dhe Anna Bendarek, anëtarë, duke vendosur me ankesat ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/203/2013 (lëndët e regjistruar në AKP me numrat KPA25088 dhe KPA90041, i datës 11 Qershor 2013, pas seancës gjyqësore të mbajtur më 3 Shkurt 2016, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Ankesat e paraqitura nga A.V. i, kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/203/2013 date 11 Qershor 2013 lidhur me lenden e regjistruar në AKP me numrat GSK-KPA-A-161/14, dhe GSK-KPA-A-162/2014, bashkohen në një lëndë të vetme me numrin GSK-KPA-A-161/2014
2. Hedhet si të pasafatshme Ankesat e paraqitura nga A.V. i, kundër vendimit të vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/203/2013 i dt.11 qershor 2013 regjistruara në AKP me numrat KPA25088 dhe KPA90041.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 7 Maj 2007, C.S. , (në tekstin e mëtejme: pala përgjegjëse në ankese) ka paraqitur në emër të nënës së tij C.S. dy kërkesa individuale në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ku kërkon të drejtën pronësinë së ngastrave 25 dhe 26 (kërkesa e regjistruar në AKP me numer 25088) dhe ngastrën 24/2 (kërkesa e regjistruar në AKP me numer 90041) që ndodhen në Zonën Kadastrale Gërlicë, Komuna e Ferizajt të regjistruar në F.P 18. Në këto kërkesa, pala përgjegjëse në ankese kishte theksuar se humbja e posedimit mbi pronat e kërkuara ishin humbur për shkak të rrethanave që kanë të bëjnë me konfliktin e armatosur që ka ndodhur në Kosovë në vitet 1998/99, ku përmendet data 16 qershor 1999 si data e humbjes.
2. Për të mbështetur kërkesat e tij kishte dorëzuar në AKP dokumentet vijuese:
 - Fletën poseduese nr. 18 të lëshuar Departamenti për Kadastër të pronës së paluajtshme të Komunës së Ferizajt datës 3 Tetor 2008, që tregon se pronat e kërkuara ishin të e regjistruara në emër të C.S..

Aktivendimin trashëgimor T. Nr. 64/96 i datës 17 qershor 1996, të Gjykatës Komunale në Ferizaj me të cilin konstatohet se titullari e së drejtës së Pronës C.S. nëna e pales përgjegjëse në ankese trashëgoi pronën e kërkuar nga bashkëshorti i saj. Këto dokumente janë verifikuar pozitivisht nga AKP.

3. Me vendimi i Komisionit vendimit të KPCC/D/A/203/2013 i dt.11 qershor 2013 konfirmohet e drejta pronësinë C.S. nënës së palës përgjegjëse në ankese së ngastrave 25,26 (Kërkesa KPA25088 dhe ngastrën 24/2 1207, (kërkesa KPA9041) Zona Kadastrale Gërlicë, Komuna e Ferizajt të regjistruar në Fletën Poseduese. Nr. 18.

Bashkimi i ankesave:

4. Neni 13.4 i Rregullores se UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 parashikon se Gjykata Supreme mund të vendose mbi bashkimin apo shkrirjen e ankesave, kur një bashkim apo shkrirje e tillë e kërkesave është vendosur nga Komisioni në pajtim me nenin 11.3 (a) të Rregullores se UNMIK e ndryshuar me ligj. Ky nen i lejon Komisionit të marrë parasysh bashkimin apo shkrirjen e kërkesave në mënyrë që të shqyrtojë dhe merr vendime aty ku ka çështje të njëjta ligjore si dhe të provave.
5. Dispozitat e Ligjit të Procedurës Kontestimore që janë të zbatueshme në procedura para Kolegjit të Apelit AKP-se të Gjykatës Supreme në pajtim me nenin 12.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, si dhe dispozita e nenit 408.1 se bashku me nenin 193 të Ligjit nr. 03/L006 të Procedurës Kontestimore, ofrojnë mundësinë e bashkimit të kërkesave përmes një aktvendimi nëse kjo do të siguronte efikasitetin e gjykatës dhe efektshmërinë e lëndës.
6. Në tekstin e ankesave të paraqitura nga pala ankuese, Gjykata Supreme vëren se përveç numrit të ndryshëm që janë paraqitur ankesat, faktet, baza ligjore dhe çështja e provave janë saktësisht të njëjta në të dyja lëndët. Vetëm ngastrat, subjekti i së drejtës pronësore që pretendohen në secilën kërkesë, janë të ndryshme. Ankesat janë të bazuara në deklaratë të njëjtë shpjeguese dhe në dokumentacionin e njëjtë. Për më tepër, arsyetimi ligjor i KKPK-së për kërkesat është i njëjtë.
7. Ankesat e regjistruara me numrat GSK-KPA-A-161/14 dhe GSK-KPA-A-162/14 bashkohen në një lëndë të vetme me numër GSK-KPA-A-161/14.

Afatshmëria e ankesave:

8. Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndes Gjykata Supreme gjeti se:

Ankesa është e pasafatshme.

9. Gjykata Supreme e Kosovës e hodhi ankesat e ankuesit si të pasafatshme sipas nenit 186 par. 1 lidhur me nenin 196 të LPK-së. Kjo ngase, se ankuesi 05 shtator 2013 e ka pranuar vendimin ankimor, ndërkaq ankesat i ka paraqitur më datë 17 prill 2014. Nga kjo mund të konstatohet se ankuesi ankesat i ka paraqitur pas afatit prej 30 ditësh të parashikuar me dispozitën e nenit nenit 12 par. 1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-79. Me këtë dispozitë ligjore

parashikohet se ankesa kundër vendimit të KPCC mund të ankohet brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e pranimit.

10. Rrjedhimisht mbi të mësipërmen e sipas dispozitës së nenit 13 par. 3 nënpar. b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-79 , , është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

Këshillë ligjore:

11. Sipas 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Gjyqtar, Kryetar i Kolegjit

Beshir Islami, Gjyqtar

Anna Bednarek, Gjyqtare e EULEX-it

Sandra Gudaityte, Referent i EULEX-